



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine - Ministry of Labour and Social Welfare

Prishtinë 10 shtator 2020

Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve në fushën e shërbimeve sociale, aftësimin profesional, punësimin, pensione dhe zhvillimit të aktiviteteve të promovimit për të drejta sociale për grupet e cënueshme

1. *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale* iu bën thirrje të gjitha Organizatave Joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në mbështetjen e kategorive sociale dhe fuqizimin e familjes/individëve në nevojë sociale, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve në fushën e shërbimeve sociale, aftësimin profesional punësimin, pensione dhe zhvillimit të aktiviteteve të promovimit për të drejta sociale për grupet e cënueshme.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për ofrimin e shërbimeve sociale, trajnimeve profesionale, angazhimit në punësim, ofrimin e shërbimeve për pensionistë dhe zhvillimin e aktiviteteve të promovimit për të drejta sociale për grupet e cënueshme.

3. Organizatat Joqeveritare mund të aplikojnë me një projekt dhe projektet që aplikojnë duhet të kontribuojnë në ofrimin dhe avancimin e shërbimeve sociale, aftësimin profesional, punësimin, shërbimet për pensionistë dhe zhvillimin e aktiviteteve të promovimit për të drejta sociale për grupet e cënueshme përmes aktiviteteve si më poshtë:

3.1 Shërbime alternative për mbrojtje të fëmijëve të braktisur dhe mbështetjen e familjeve strehuese për ofrimin e shërbimeve për fëmijë;

3.2 Shërbime rezidenciale, ditore dhe në familje për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara;

3.3 Shërbime rezidenciale, ditore dhe në familje për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare;

3.4 Shërbime rezidenciale dhe ditore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit;

- 3.5 Trajnim profesional dhe angazhim në punësim për të rriturit me aftësi të kufizuara, si dhe mbështetje e të rinjve për zhvillimin e shkathtësive për qasje në tregun e punës;
 - 3.6 Trajnim profesional dhe angazhim në punësim për përfituesit e kategorisë së II të Skemës së Ndihmë Sociale, gratë dhe të rinjtë e papunë të regjistruar në Zyrat e Punësimit;
 - 3.7 Ofrimi i mbështetjes në zbatimin e aktiviteteve të organizatave dhe shoqatave që merren me fushën e promovimit të të drejtave sociale për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, të burgosurit politik dhe grupeve e tjera të cenuara;
 - 3.8 Ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes, këshillimeve psiko-sociale për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.
4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **1,000,000** euro. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e aktiviteteve nga pika **3.1** deri **3.6** shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një (1) projekt është **5,000** euro, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është **15,000 euro**. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e aktiviteteve të përfshira në pikën **3.7** dhe **3.8** shuma minimale e mbështetjes për një (1) projekt është **3,000 euro**, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është **5,000** euro.
5. Varësisht prej llojit të fushës dhe ofrimit të shërbimeve projekti mund të financohet deri në 100 % të totalit të kostove të pranueshme të projektit, por jo më shumë se sa vlera minimale dhe maksimale për një projekt individual të përcaktuar në pikën nr. 4 të kësaj thirrje dhe kritereve të përcaktuara në *Udhëzuesin për Aplikantët*.
6. Aplikantët mund të sigurojnë dhe paraqesin bashkëfinancim në projekte nga donatorët dhe burime të tjera publike apo burimet vetanake.
7. Afati i fundit për dorëzimin e propozim projekteve është pesëmbëdhjetë (15) ditë pune dhe përfundon me datën 30 Shtator 2020.
8. OJQ-të mund të aplikojnë ose të jenë partnerë vetëm në një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje publike.
9. OJQ-të aplikuese mund të dëshmojnë se programi i punës se tyre është i fokusuar në ndonjërin nga llojet e fushës dhe aktiviteteve të përfshira në kuadër të kësaj thirrje publike, përmes dorëzimit të statutit apo dëshmisë për zbatimin e projekteve të ngjashme.
10. OJQ-të të cilat kanë marr mbështetje financiare nga thirrjet publike apo përmes ndonjë marrëveshjeje bashkëpunimi me MPMS-së gjatë vitit 2020, nuk mund të përfitojnë nga kjo thirrje publike.

11. Periudha e zbatimit të projektit është për 3-6 muaj. OJQ-të mund të përfshihen më së shumti në një (1) projekt dhe në zbatimin e 1-2 fushave prioritare, të cilat janë pjesë e kësaj thirrje publike.

12. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e Organizatave Joqeveritare në Republikën e Kosovës, ndërsa OJQ-të të cilat aplikojnë për zbatim të projekteve sipas pikës 3.1 deri 3.4 të kësaj thirrje, duhet të janë të **licencuara** nga MPMS-ja.

13. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga llojet e fushës të përfshirë në kuadër të kësaj thirrje publike.

14. OJQ-të duhet po ashtu, të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

15. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

16. Propozimet do të dorëzohen në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale*.

17. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Sheshi Miss Edit Durham nr. 46, pranë Hotel Grandit

10 000 Prishtinë, Zyra e Arkivit në MPMS.

18. Procesi i pranimit, hapja dhe shqyrtimi i aplikacioneve, vlerësimi i aplikacioneve, kontraktimi, dhënie e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

19. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

20. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, tek z. Ylber Kokollari - Zyrtar për licencim, duke e kontaktuar përmes e-mailit në adresën: ylber.kokollari@rks-gov.net.